



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Ministria e Punëve të Jashtme  
Ministarstvo Inostranih Poslova - Ministry of Foreign Affairs

AKADEMIA DIPLOMATIKE  
Diplomatska Akademija - Diplomatic Academy



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
HASAN PRISHTINA

## MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT

në mes të

**AKADEMISË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

dhe

**FAKULTETIT JURIDIK TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

Akademia Diplomatike e Republikës së Kosovës dhe Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, më poshtë të quajtura “Palë”;

Të vendosura për të nënshkruar këtë Marrëveshje të Mirëkuptimit me qëllim të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave në fushën e diplomacisë dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare, të drejtës ndërkombëtare dhe të disiplinave të tjera akademike;

Pajtohen si më poshtë:

### **Neni 1 Qëllimi**

Akademia Diplomatike dhe Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” do të bashkëpunojnë në shkëmbimin e ligjëruesve, ofrimin e ligjëratave në lëmin e diplomacisë, të drejtës ndërkombëtare, historisë moderne politike, si dhe në studimin dhe hulumtimin e temave me interes të përbashkët.

## **Neni 2**

### **Bashkëpunimi**

Të dy palët e marrëveshjes janë pajtuar që të ofrojnë ligjërata, konferenca dhe seminare për kandidatët me tema me interes të përbashkët në hapësirat e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe të Akademisë Diplomatike të Republikës së Kosovës. Të dy institucionet do të bashkëpunojnë reciprokisht dhe do t'i ofrojnë njëra tjetrës ndihmën e duhur gjatë organizimit të ngjarjeve me interes të përbashkët.

## **Neni 3**

### **Format e bashkëpunimit**

Akademia Diplomatike e Republikës së Kosovës do të sigurojë ligjërues nga radhët e diplomatëve të Republikës së Kosovës, nga radhët e trupit diplomatik të akredituar pranë Republikës së Kosovës, si dhe nga institucionet simotra ndërkombëtare. Edhe Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" do të ofrojë ligjërues.

## **Neni 4**

### **Publikimi i punimeve**

Të dy institucionet do të lehtësojnë publikimin e punimeve nga të dy partnerët në organet respektive institucionale, si dhe të teksteve me interes nga institucione të tjera publike apo private, qofshin ato vendore apo ndërkombëtare.

## **Neni 5**

### **Shkëmbimi i informacionit**

Akademia Diplomatike e Republikës së Kosovës dhe Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" do të shkëmbejnë informacione me interes të përbashkët, përfshirë edhe pjesëmarrjen e përbashkët ose vetanake në takimet apo konferencat ndërkombëtare.

## **Neni 6**

### **Aspekti financiar**

Ky dokument përbën marrëveshjen e plotë në mes të palëve. Marrëveshja nuk konsiderohet kontratë obliguese financiare, ajo është dizajnuar për efekt të avancimit, bashkëpunimit dhe zhvillimit institucional të dy palëve.

## Neni 7

### Hyrja në fuqi, përfundimi dhe plotësim – Ndryshimi


Marrëveshja e Mirëkuptimit hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi për pesë (5) vite. Marrëveshja mbetet në fuqi në mënyrë automatike edhe për pesë (5) vite tjera, nëse palët nuk fillojnë procedurën e ndërprerjes së kësaj marrëveshjeje të mirëkuptimit.

Kjo Marrëveshje, mund të ndërpritet nga njëra prej palëve nënshkruese pas paralajmërimit me shkrim, së paku tre (3) muaj para ndërprerjes. Aktivitetet e filluara para kërkesës me shkrim për ndërprerje të marrëveshjes, do të përfundohen sipas planifikimit paraprak, përveç rasteve kur palët pajtohen për të marrë vendim tjetër.

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, mund të ndryshohen apo plotësohen me pëlqimin paraprak me shkrim të Palëve.

E nënshkruar në **Prishtinë**, më **22 prill 2016**, në dy kopje origjinale autentike, në gjuhën shqipe.


Për Akademinë Diplomatike të Republikës  
së Kosovës:



Dr. **Skender Durmishi**, Ambasador


Drejtor i Përgjithshëm

Për Fakultetin Juridik të Universitetit të  
Prishtinës "Hasan Prishtina":



Prof. Ass. Dr. **Haxhi Gashi**

Dekan



Dr. **Iliriana Islami**, Prof. Assoc.

Prodekan për Marrëdhënie me Jashtë dhe  
Cilësi

Katedra e të Drejtës Ndërkombëtare